


Sistemi i kompjuterizuar gjithëpërfshirës i KMSHC-së, Komisioneri nis takimet konsultative

Nën kujdesin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), nisën takimet konsultative me drejtoritë e Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) dhe ekspertët e teknologjisë së informacionit, për të ngritur sistemin e kompjuterizuar gjithëpërfshirës, për aktivitetin e institucionit, si dhe zhvillimin e platformës digjitale, ku nëpunës civilë dhe qytetarë mund të paraqesin shqetësimet e tyre, nëse vërehen shkelje të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil dhe në të gjitha institutet e tjera të ligjit “Për nëpunësin civil”.



Ngritja e sistemit të kompjuterizuar të KMSHC-së, është adresuar në rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, për të rritur transparencën dhe komunikimin publik, duke vlerësuar se Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka rol parësor, për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent.



Sistemi i kompjuterizuar i KMSHC-së, do të shërbejë edhe për; Mbikëqyrjen e përgjithshme dhe tematike, të subjekteve me tipologji të ndryshme të institucioneve në shërbimin civil; Realizimit të mbikëqyrjes së skemës së funksionimit të shërbimit civil, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore; Realizimit të mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, si dhe monitorimeve online në lidhje me rekrutimet e kryera nga Departamenti i Administratës Publike dhe administratës vendore.